



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KESHILLI

Nr. 2378/6 prot

Koplik më: 31/10 / 2022

V E N D I M

Nr 50 datë 31 /10 / 2022

PËR

1. "Miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor përkatës, të z. Fejzi Ujkaj, objekti shtepi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, si dhe për akordimin e ndihmës financiare për familjen e shtetasit Fejzi Ujkaj nga programi Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, programi 3280, në mbështetje të VKB Malësi e Madhe nr 70 datë 29.12.2022 "për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afat mesem 2022-2024 të Bashkisë Malësi e Madhe".

Baza Ligjore

Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar

Ligji për Prefektin e Qarkut

Ligji Nr. 45/2019 Për mbrojtjen civile,

VKM nr.329 datë 16/5/2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"

VKM, Nr.965, datë 02/12/2015 „Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave“.

Vendosi;

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Malësi e Madhe për mbështetje financiare të familjes së shtetasit z. Fejzi Ujkaj, objekti shtepi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit,.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko - ligjor përkatës të hartuar nga Bashkia Malësi e Madhe për demtimin e banesë nga rënia e zjarrit.
3. T'i akordojë familjes së shtetasit Z. Fejzi Ujkaj, objekti shtepi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, dhënien e ndihmës së menjëherëshme/emergjente financiare në vlerën/shumen 100.000 (njëqind mijë) lekë , në mbështetje të VKB Malësi e Madhe nr.70, datë, 29.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 të Bashkisë Malësi e Madhe " , nga fondi i buxhetit të Bashkisë Malësi e Madhe, nga Programi "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, programi 3280".
4. T'i paraqesë dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës të familjes së shtetasit **Z. Fejzi Ujkaj**, objekti shtepi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit.
5. Ndiurma financiare për familjen e shtetasit Z. Fejzi Ujkaj, përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012.

6. Ndhurma financiare që do të akordohet do të përdoret për t'i ardhur në ndihmë familjes së shtetasit **Z. Fejzi Ujkaj**, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit.

7. Vlera e dëmeve në orendi, mobilje dhe paisje elektroshtëpiake është 245.000 (dyqind e dyzet e pese mije) leke.

Dëmtime nga ana ndërtimore ska

Vlera në total e dëmeve është : 245.000 (dyqind e dyzet e pese mije) leke.

8. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKREYAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 31.10.2022

Vota Pro 20

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 02.11.2022

